


HIDR DRINI



PLANI I BIZNESIT 2018-2020

Kryesuesi i BtD _____

Tabela e përmbajtjes

0	Përmbledhja.....	3
1	Përshkrim i Shkurtër i Kompanisë.....	4
1.1	Historiku i Kompanisë	4
1.2	Deklarata e Politikës	6
1.3	Qëllimet dhe Objektivat Strategjike Afatgjate	6
2	Vlerësimi i Përformancës në Vitin Paraprak (2017) dhe Planifikimi.....	8
2.1	Shërbimi Teknik	9
2.2	Financat dhe Shërbimi Komercial	10
2.3	Resurset Humane	10
3	Plani Operativ	11
3.1	Parashikimi i kërkesës për Shërbime të Ujit të Pijshëm, Grumbullim dhe Trajtim të Ujërave të Zeza.....	11
3.2	Prodhimi, Kualiteti, dhe Shpërndarja e Ujit të Pijshëm.....	12
3.3	Cilësia e ujit të shpërndarë.....	12
3.4	Kontrollimi i ujit të shpërndarë.....	12
3.5	Caktimi i Pilot Zones për Veprim të.shket.....	15
3.6	Grumbullimi i Ujërave të Zeza	13
3.7	Trajtimi i Ujërave të Zeza	13
4	Plani i Shërbimit Komercial.....	13
4.1	Përdatësimi i bazës së të dhënave	13
4.2	Instalimi i ujëmatësve.....	14
4.3	Saktësia e leximit të ujëmatësve	14
4.4	Faturimi	15
4.5	Arkëtimi-Inkasimi.....	15
4.6	Reziqet	15
4.7	Relacionet me konsumatorë	16
4.8	Komunikimi me publikun.....	16
5	Plani Financiar	16
5.1	Pagesa e Shenzimeve.....	17
5.2	Siguria Financiare.....	17
5.3	Grandet.....	17
5.4	Kontigjentet dhe detyrimet.....	18
5.5	Teknologjia Informative.....	18
5.6	Plani i Prokurimit.....	18
6	Plani i Zhvillimit të Stafit	21
6.1	Struktura Organizative.....	21
6.2	Plani i Trajnimit të Stafit	22
6.3	Plani i Stimulimit të Stafit.....	22
7	Plani i Menaxhimit të Aseteve.....	22
7.1	Plani i Investimeve në 2018-2020.....	23

shtojca buxhetimi 2018

0 Përmbledhja

Plani i Biznesit 2018-2020 është përgatitur në aspektin strategjik dhe operacional të tij nga Bordi i Drejtorëve të Kompanisë Regjionale të Ujit Hidrodrinidhe nga Menaxhmenti Ekzekutiv i Kompanisë. Duke respektuar Ligjin për Ndërmarrjet Publike në Kosovë, ky Plan Biznesi i dërgohet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik si dokument informativ.

Plan Biznesi përshkruan qëllimet, strategjitë dhe aktivitetet e propozuara të Kompanisë që do të synohen të plotësohen dhe ndërmerren gjatë periudhës 2018-2020. Poashtu, përfshinë edhe planet detaje të veprimeve të cilat do të ndërmerren gjatë vitit 2018. Prandaj, ne konsiderojmë se ky plan do të n'a shërbejë si udhërrëfyes në realizimin e caqeve të Kompanisë si dhe në monitorimin e përmbushjes së tyre.

Gjatë periudhës planifikuese 2018-2020 pritet të zgjerohet zona e mbulimit me shërbime të ujit dhe kanalizimit, duke përfshirë edhe ato pjesë të cilat do të duhej të inkuadroheshin në zonën e përgjithshme të shërbimit. Deri në fund të vitit 2018 përqindja e furnizimit me ujë të pijshëm do të jetë me shume se 96%, kurse deri në vitin 2020, Peja dote kete Impiantin e Trajtimit të Ujerave të Zeza.

Faturat do t'i lëshohen të gjithë konsumatorëve të regjistruar, çdo muaj, duke u bazuar kryesisht në konsumin e lexuar. Gjatë periudhës 2018-2020 pritet të ngritet norma e faturimit e bazuar në lexim të ujëmatësve deri në 97%. Këtu do të përfshihet edhe pastrimi i bazës së të dhënave për të larguar konsumatorët jo-ekzistent.

Të ardhurat dhe shpenzimet e Kompanisë janë analizuar nga secila qendër-njesi e të ardhurave/shpenzimeve. Që të arrijë qëllimet e saja kryesore Kompania planifikon të arkëtoj €3.120.000 në 2018. Të ardhurat e krijuara do të mjaftojnë për mbulimin e të gjitha shpenzimeve operative dhe nevojave për investimet e parapara për periudhën planifikuese.

Resurset njerëzore do të vazhdojnë të pranojnë trajnimet e duhura varësisht prej nevojës dhe në përputhje me arritjen e synimeve afatshkurtëra dhe afatmesme të Kompanisë.

1 Përshkrim i Shkurtër i Kompanisë

1.1 Historiku i Kompanisë

Kompania Rajonale për Ujë dhe Kanalizim Hidrodrini është themeluar në Tetor te vitit 2004 ne bazë të marrëveshjes së përbashkët ndërmjet Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), dhe pese komunave (Pejë, Deçan, Istog, Kline dhe Junik).

Nga data 31.05.2007 K.U.R “Hidrodrini” Sh. A., nga Qeveria e Kosovës gjegjësisht nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik është pajtuar të zhvilloj aktivitetin me numër të ri të biznesit 70432209. Kompania si Shoqëri Aksionare është e organizuar sipas rregullit ekzistues të ligjeve të Kosovës.

Sipas Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrje Publike jemi nën Ministrin e Zhvillimit Ekonomik të Republikës të Kosovës si Ndërmarrje Publike Qendrore.

K.U.R “Hidrodrini”Sh. A. është institucion publik profesional i licencuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit, për ofrimin e shërbimeve baze, të furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbimet kanalizimit.

Numri popullatës që Kompania Rajonale „HIDRODRINI” iu kryen shërbime me ujë të pijes vlerësohet rreth 185.000 banor, ndërsa shërbimet e ujërave të zeza 65,000 banor. Kapaciteti momental prodhues sillet afërsisht rreth 25.000.000 m³/Vjet.

Kompania është dhe do të mbetet ofruer profesional i furnizimit me ujë të pijshëm të kualitetit të lart dhe të shërbimeve të kanalizimit. Prodhimi, shitja e ujit, shërbimet e kanalizimit dhe shërbimet tjera janë detyrat kryesore të kompanisë.

Qendra e kompanisë është në Pejë, në strukturën e vetë ka 5 njësi të biznesit në Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Decan. Përbëhet prej katër departamenteve dhe katër zyrave profesionale.

Bordi i Drejtoreve i përzgjedhur nga Kryeministri, është organ i pa varur dhe bënë drejtimin dhe mbikëqyrjen e biznesit të kompanisë. Stafi menaxhues i kompanisë organizon punën, kryen udhëheqjen efektive të veprimtarisë dhe stafit.

Në kuadër të furnizimit apo të prodhimit të ujit të pijshëm në Kompaninë Rajonale Hidrodrini ka këto të dhëna të Biznesit:

Nj. O. Pejë:

(Kjo Njësi Operacionale furnizon me ujë të pijes qytetin e Pejës dhe rreth 46 fshatra për rreth.), kemi dy objekte prodhuese kryesore, Uji i Zi me dy sisteme të pompimit dhe gravitet dhe Drini i Bardhë me gravitet

Njësia Operacionale në Pejë ka dy Stacione kryesore te pompimit dhe 15 stacione tjera ndihmese:

Me dy Depo të ujitë të pijshëm me rreth 1500m³ dhe 3000m³ ku depoja prej 1.500m³, nuk është ne funksion.
415 km rrjetë i ujit me tubacione të profileve të ndryshme.
80 km rrjetë i kanalizimit të fekaleve.
Dy Stacione të Klorinimit.

Nj. O. Istog:

(Kjo Njësi Operacionale furnizon me ujë të pijes qytetin e Istogut dhe rreth 46 fshatra për rreth.)

Tetë Depo(Rezervuare) te ujit me kapacitet 700m³, 400m³, 400m³, 800m³, 500m³, 200m³, 400m³, 400m³,
Shtatë stacione te pompimit,
Pesë stacione te klorinimit
Një rrjetë prej 248km te dimensioneve prej Dn50 deri ne Dn500 gypësjelles të ujit.
Një rrjetë prej 38km te kanalizimit te ujerave fekal.

Nj. O. Klinë:

Burimi i ujit Jarinë furnizon me ujë qytetin e Klinës dhe disa fshatra. Fabrika ka një kapacitet prodhues prej 310 m³/orë (86.1 l/s), por meqenëse uji që vjen nga puset është në një sasi më të vogël dhe uji i basenit të hapur është me turbullirë të lartë. Prodhimi i ujit varet nga turbullirat e ujit të lumit Drini i Bardh.
(Kjo Njësi Operacionale furnizon me ujë të pijes qytetin e Klinae dhe rreth 25 fshatra për rreth.)

Një Stacion i klorinimit
Katër Depo të ujit me kapacitet 1000m³, 800m³, 400m³, 400m³ dhe 50m³
Një rrjetë prej 150 km gypësjelles të ujit.
Dy Stacione kryesore të pompimit,
Një Impiant të ujitë të pijshem,
40 Km rrjetë te kanalizimit.

Nj. O. Junik:

(Sistemi i furnizimit me ujë është sistem me gravitet, kemi nje burim me kapacitet (30-45) l/s.

Dy Depo te ujit me kapacitet 500m³ dhe 35 m³
Një rrjetë prej 45 km gypësjelles të ujit.

Nj. O. Decan:

(Sistemi i furnizimit me ujë është me sistem me gravitet, përpos sistemit kryesor, kemi edhe sistemin e Strellcit, Isniqit si dhe sistemin e ujitë për pesë fshatra: Broliq, Prapaqan, Dubovik, Kryshec, Papiq, Broliq dhe sistemi kryesor i Deçanit ku furnizohen këto fshatra: Carabregu i Epërm, Carrabregu i Poshtëm, Belegi dhe Lluka e Epërme, Lluka e Ulët)
Kemi Pesë Depo (Rezervar) me Kapacitet prej: Coopi 530m³, Nca 508m³, Strellc 720m³, dhe CDF 812m³.

Stacione të Klorinimit,
Pesë depo(rezervuare) me kapacitet 530m³, 508m³, 720m³ dhe 812m³,
Një rrjetë prej 117 km gypësjelles.

1.2 Deklarata e Politikës

Vizioni i Kompanisë është që deri në fund të vitit 2019 të sigurojë furnizim të pandërprerë me ujë të pijes gjatë 24 orëve për tërë regjionin e Pejës, Istogut, Deçanit, Klina dhe Junikut; pajisjen me ujëmatës të të gjithë konsumatorëve; zvogëlimin e humbjeve të ujit, si dhe përmirësimin e përgjithshëm të imazhit të kompanisë ndaj konsumatorëve.

Misioni i përgjithshëm i Kompanisë është që të bëjë furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhjen e ujërave të zeza, mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtjen e impianteve për trajtimin e ujit të pijshëm dhe mirëmbajtjen e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, pasi të perfundon implementimi. Orientimi i aktiviteteve të punës do të kenë konsumatorin në qendër të vëmendjes. Të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe qasje në shërbim pa diskriminim: racor, religjioz, kombëtar, apo gjinor.

Kompania zotohet në shfrytëzimin racional të burimeve të ujit dhe në mirëmbajtjen e rregullt të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Kompania është përfundimisht e orientuar në plotësimin dhe kënaqjen e kërkesave të konsumatorëve të saj, përkundër natyrës monopolistike të biznesit të saj, si dhe sigurimin e transparencës dhe bashkëpunimit me të gjithë akterët e sektorit të ujit në Kosovë dhe më gjerë.

Implementimi i misionit të Kompanisë mund të përcillet me rreziqet eventuale të natyrave të ndryshme si: (i) mungesa e ujit në burime si pasojë e mungesës së reshjeve atmosferike; (ii) kriza sociale-ekonomike në nivel të vendit ose lokal me ndikim në mosrealizimin e të ardhurave të gatshme; (iii) mosgatishmëria e donatorëve potencial në financimin e projekteve investive të nevojshme; si dhe (iv) fatkeqësitë e papritshme natyrore.

1.3 Qëllimet dhe Objektivat Strategjike Afatgjate

Kompania funksionon me vendim-marrje dhe llogaridhënie nga Bordi i Drejtorëve, në përputhshmëri me principet e qeverisjes së përbashkët.

Bordi i Drejtorëve, duke përfshirë Drejtorët Jo-ekzekutiv dhe Drejtorët/Zyrtarët Ekzekutiv, për të gjitha aktivitetet bazë, për një periudhë më afatgjatë (deri në 2020) ka përcaktuar qëllimet kryesore strategjike si në vijim:

Zvogëlimi i ujit të pafaturuar, do të arrihet përmes objektivave të poshtë shenuara:

- ✓ Përkushtim, angazhim më i madhë i punëtorëve në teren.
- ✓ Matje korrekte të konsumit.
- ✓ Instalim të ujëmatësve në zonat dhe caktimi i zonave DMA.
- ✓ Riparim të rrjedhjeve sipërfaqësore.
- ✓ Identifikim të rrjedhjeve nëntokësore në kuader të menaxhimit të humbjeve.
- ✓ Reduktim të sasisë së ujit në zona të caktuara (presioni).
- ✓ Identifikim të shfrytëzuesve të pa autorizuar (vjedhja e ujit).
- ✓ Rritje e numrit të konsumatorëve.
- ✓ Rritjen e investimeve në zëvendesim e gypave të vjetër.
- ✓ Rritja e shkallës së arkëtimit.
- ✓ Hartimi i listave me emra të borxhlive dhe procesimi me Përmbarues.
- ✓ Vazhdimi i kontratës me PTK, dhe kontrata të reja me shërbime që ofrojnë këto shërbime të pagesave për pagesat e faturave në pikat e tyre.
- ✓ Hartimi i listës investuese prioritare për donatorët potencial.
- ✓ Ngritja e efikasitetit të stafit.
- ✓ Sistemimi i punëtorëve.
- ✓ Përfundimi i zbatimit të Ligjit dhe Rregulloreve të brendshme.

Një përkushtim i veçantë në periudhat që vijnë do të jetë mbulimi i zonës së shërbimit me ujëmatës sidomos në zonat ku ka sasi më të mëdha të ujit dhe atje ku keqpërdorimet janë të mëdha, kjo do të arrihet me aktivitet si në vijim:

- Zgjerimin e zonës së shërbimit deri në më shumë se 97%.
- Furnizimit me ujë të konsumatorëve ekzistues dhe atyre të ri në 24 orë.
- Sigurimin e shfrytëzimit racional të burimeve të ujit.
- Adoptimin e Rregulloreve të ARRU përfshirë atë të Standardeve Minimale të Shërbimeve, Kartën e Konsumatorëve, Politikën Tarifore të ARRU, dhe të tjera, për sigurimin cilësor të shërbimeve si dhe arritjen e të ardhurave të mjaftueshme që do të mund të mbulojnë shpenzimet operative dhe investimet e domosdomshme vjetore që do të dalin nga Planifikimi i Menaxhimit të Aseteve sipas standardeve evropiane.
- Përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm në pajtim me standardet e IKSHP.
- Arritjen e vetëqëndrueshmërisë financiare.
- Promovimin e relacioneve të mira me konsumatorë.
- Krijimin e një ambienti të favorshëm të punës për të gjithë të punësuarit.
- Regjistrimin dhe ruajtjen elektronike të të dhënave dhe informacioneve të Kompanisë dhe organizimin e tyre në një Sistem Informativ Menaxhues funksional.

- Ne planifikojmë që qëllimet strategjike afatgjata të lartë përmendura të l realizojmë duke shfrytëzuar resurset e Kompanisë por dhe përmes mbështetjes nga institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe donatorëve aktual siç janë Banka Gjermane KfW, Qeveria Zvicerane dhe USAID –i dhe Bashkimi Evropian.

2 Vlerësimi i Përformancës në Vitin Paraprak (2017) dhe planifikimi.

Gjatë vitit 2017 (duke i referuar të dhënave aktuale për nëntë mujorit të vitit) Kompania ka përfomuar shume mirë, në tregues kryesor, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Hidrodrini sipas ketij vlerësimi do të hartoj edhe planifikimin për vitin 2018.

Aktivitetet kryesore te ndermarra gjatë vitit 2017:

Reduktimi i humbjeve teknike dhe administrative, eliminimi i mangësive në sistemin e inkasimit.

Aritja e kriterëve të përcaktuara nga Banka Gjermane Zyra Zvicerane dhe Kuvendit Komunal – Pejë, të cilat kane qene kushtë për Investimet ne ITUZ, në vlerë prej 25 milion euro.


Implementimi i projekteve donacion nga Zyra Zvicerane

Reduktimin e lidhjeve të paligjshme-lidhjet ilegale.

Pasqyra e përformances operative dhe financiare në krahasim me vitet paraprake dhe planifikimi për 2018.

Vitet	2014	2015	2016	2017	2018 P
Prodhimi(m3)	29.782.872	25.559.988	25.563.723	25.650.000	25.200.000
Faturimi(m3)	8.682.341	8.774.145	9.000.000	9.300.000	9.900.000
Humbjet (%)	71%	66%	65%	64%	59%
Shpenzimet (Euro)	2.068.872	2.191.685	2.285.879	2.450.000	2.760.000

Vitet	2014	2015	2016	2017	2018 P
Faturimi (euro)	3.369.691	3.443.182	3.537.082	3.650.000	4.080.000
Inkasimet (euro)	2.239.383	2.507.335	2.764.127	2.850.000	3.120.000
Shkalle në %	66%	66%	78%	78%	76%
Norma e mbulesës së punës	1.12	1.16	1.23	1.17	1.08



Përformanca kater vjeçare dhe ajo planifikuese është tregues mbi zhvillimet e përgjithshme financiare dhe operacionale të kompanisë.

Vlersimi i përformances mujore dhe tashmë edhe ajo vjetore. Ku përformanca e K.R.U “Hidrodrini” është bërë me aplikimin e standardeve dhe treguesve të përformancës. Projekti i zbërthyer në terma më të thjesht ka mundësuar që menaxhmenti të angazhohet për një përformancë efektive duke përfshirë procesin e përmirësimit, zhvillimit të aktiviteteve dhe rezultatet e arritura dhe rezultateve që duhet arritur.

2.1 Shërbimi Teknik

Mesatarisht gjatë vitit 2017, Kompania, ka arritur të sigurojë ujë të pijshëm, të realizojë mirëmbajtjen e rregullt të sistemit të ujësjellësit si dhe kanalizimit, përkundër përballjes me problemet e sjellura nga rrjeti i ujërave atmosferike sidomos gjatë stinës së pranverës.

Kualiteti i ujit të pijshëm të shpërndarë në tërë zonën e shërbimit është monitoruar rregullisht nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe rezultatet e ujit të furnizuar janë të kënaqshme edhe gjatë vitit 2018, planifikojme që kualiteti të plotesoj kerkesat e standardeve.

Kualiteti i Ujit- K.U.R”Hidrodrini”	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018 P
Totali i testeve të realizuara	2240	2300	2397	2500	2556
- Që nuk janë ne pajtim me standardet	50	45	4	5	7
- % (keq)	3%	2%	1%	1%	1%

Aktivitetet e ndërmarra gjatë vitit 2017 kanë pasur kryesisht të bëjnë me identifikimin e lidhjeve ilegale dhe konsumatorëve Ilegal. Rezultatet kanë qenë mjaft pozitive prandaj ky aktivitet do vazhdojë edhe në vitin 2018. Përkundër aktiviteteve të lartpërmendura, kompania ende përballet me përqindje të lartë të ujit të pafaturuar prej (60-65)%.

2.2 Financat dhe Shërbimi Komercial

Numri total i klientëve gjatë viteve:

Në vitin 2014 ka qene 40.500 konsumator të regjistruar.

Në vitin 2015 kemi ~ 43.000 konsumator të regjistruar.

Në vitin 2016 kemi ~ 44.223 konsumator të regjistruar.

Në vitin 2017 kemi ~ 47.000 konsumator të regjistruar.

Planifikimi për vitin 2018 ~48.900 konsumatorë.

Norma e Mbuleses së punes gjatë viteve 2014– 2017 dhe planifikimi.

2014.....(1.12)

2015.....(1.16)

2016.....(1.23)

2017.....(1.17)

2018p.....(1.08).

Të Gjitha vitet kemi siguruar qendrueshemeri.

(Ky është raporti në mes hyrave dhe shpenzimeve).

2.3 Resurset Humane

Gjatë vitit 2017 per hire te efikasitetit te stafit në kemi punuar ne strukturën organizative, ku edhe gjate vitit 2018 do te punohet nese eshte novoja, ashtu që te behet sistemimi organizativ, ku secili puntore te kryej detyrat e percaktuara nga udheheqesit e sektoreve..

Menaxhmenti i Kompanisë konsideron se kapacitetet njerëzore të Kompanisë nuk janë ende në nivelin e kërkuar sa i përket anës profesionale dhe këto aspekte të stafit do të adresohen gjatë viteve planifikuese 2018-2020.

Pasi që gjate vitit do te kemi ne ombrell fshatrat te cilat do te menaxhohen nga Hidrodrini, ne se do te shikojme mundsine e regrutimit te punetoreve te rinj, ku kemi nevoja ne gjith rajonin, sipas nje vlersimi ne planifikojme qe stafi te ritet per 9 punetore.

3 Plani Operativ

3.1 Parashikimi i kërkesës për Shërbime të Ujit të Pijshëm, Grumbullim dhe Trajtim të Ujërave të Zeza

Kompania edhe për periudhën planifikuese 2018-2020 do të siguron shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit në regjionin e komunave: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Decan.

Plani i Operimeve teknike në rrjetin e ujit të pijshëm, kanalizimeve stabilimenteve tjera ujore në vitin 2018 do të koncentrohet në këto kërkesa:

- Organizimi i strukturës organizative dhe sistemimi i punëtorëve që është punuar gjatë vitit 2017, duhet të implementohet tersisht, gjatë vitit 2018.
- Reduktimi i Ujit të pa faturuar prej 65% në 60%, si dhe ngritja e Inkasimit.
- Implementimi i Projekteve nga donacionet, Impianti i Trajtit të Ujërave të Zeza në Pejë, me donator: KfW, Z. Zvicëranë, KK-Pejë dhe Qeveria.
- Hartimi i listës së re Investuese, (mundësia e zgjerimit të rrjetit si dhe përfshirja e rrjetit të kanalizimeve të ujërave fekale dhe ujërave atmosferike- Impiantet e pastrimit të ujërave fekal në Njësitë tjera Operative).

- Organizimi i sistemimit të departamenteve si dhe përshkrimi i punëve për të gjithë puntoret dhe kontratat e punëtorëve pra, sistemimi dhe ndarja e përgjegjësive, këtu rëndësi të veçantë do të ketë edhe konsulenca e jashtme e cila do të bëjë analizë të strukturës ekzistuese dhe pastaj do të bëjë propozime rreth strukturës së re organizative, pra me prevojë evropiane.

Reduktimi i humbjeve dhe ngritja e Inkasimit do të arihet me:

a) Implementimin e detektimit të humbjeve me pajisje për detektimin e humbjeve teknike në terren si dhe kontrollimi i zonave në metodën shtepi për shtëpi.

b) Me aktivitetet e Shërbimit të Konsumatorëve:

- Ndryshimet në Inkasim
- Përcjdhja sistematike e borxhlinjave në të gjitha sektorët si dhe shkyçja e tyre, përcjdhja do të bëhet nga analizat e faturimit dhe Inkasimit.
- Nenshkrimi i Kontratave me konsumatorë.
- Paditja e konsumatorëve për mos pagesë me përmbarues privat,
- Koordinimi mes departamenteve,
- Përpilimi i Rregulloreve dhe procedurave të brendshme.
- Kampanja me Media,
- Si dhe kontaktet me thirrje telefonike me konsumatorë dhe hapja e pikave të reja për inkasim.

Gjatë periudhës planifikuese 2018-2020 pritet të shtohet numri i konsumatorëve të regjistruar për, kjo varet edhe nga projektet që janë në vazhdimësi, pra projektet e qeverisë Zvicëranë, si dhe projektet e implementuar me iniciativë të Kuvendeve Komunale.

3.2 Prodhimi, Kualiteti, dhe Shpërndarja e Ujit të Pijshëm

Objektivi kryesor i Menaxhmentit të Kompanisë si gjithnjë mbetet menaxhimi i kërkesës për ujë në regjionin e mbuluar nga Kompania ashtu që konsumatorëve ti sigurohen shërbime 24 orë në ditë/7 ditë në javë.

Ne secilen pike të prodhimit do të behet rehabilitimi i Ujematesve të prodhimit si dhe nderimi sipas nevojës.

3.3 Cilësia e ujit të shpërndarë

Edhe në periudhën planifikuese, Kompania do të kujdeset që uji të prodhohet/trajtohet sipas standardeve të cilësisë së ujit të përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP), në këtë mënyrë synohet të arrihet pajtueshmëria prej 100% me standardet e ujit të pijshëm në Kosovë. Paralel me këtë, IKSHP do të vazhdojë të kontrollojë cilësinë e ujit përmes testimit të mostrave të ujit të nxjerrura nga pika të ndryshme të furnizimit nga Kompania.

3.4 Kontrollimi i ujit të shpërndarë

Gjatë periudhës planifikuese 2018, Kompania do të ndërmerr masa më rigorozë për kontrollimin e shpërndarjes së ujit të prodhuar përmes përgatitjes së një strategjie të hollësishme për zvogëlimin e ujit të pafaturuar e cila si pikënisje do të ketë përdatësimin e vazhdueshëm të Modelit të Bilancit të Ujit.

Niveli i lartë i ujit të pafaturuar (humbjeve teknike dhe komerciale), jo vetëm se humben të ardhura përmes rrjedhjes së ujit dhe vjedhjes së ujit, por edhe shtohen mundësitë për dëmtimin e infrastrukturës dhe pronës. Me zvogëlimin e ujit të pafaturuar do të vijmë deri te sasi të shtesë të ujit me të cilat mund të kënaqen kërkesat momentale për ujë – pasi që në shumicën e rasteve uji i vjedhur edhe është harxhuar në sasi të mëdha për ujitje apo qëllime të tjera. Ky zvogëlim do të ndikonte poashtu edhe në zvogëlimin e kostos për ujin e shitur si dhe rritjen e të ardhurave.

Për të kontrolluar dhe zvogëluar ujin e pafaturuar Kompania do të merr masat si në vijim:

Riorganizojë Ekipin e Kontrollës për identifikimin në teren të (i) konsumuesve ilegal; (ii) konsumatorëve pasiv; (iii) shfrytëzimeve të paligjshme të ujit nga konsumatorët e regjistruar (by-pass); (iv) kontrollimin e saktësisë së leximit të ujëmatësve; (v) identifikimin e ujëmtësve jo-funksional. Këto të dhëna pastaj do të futen në hartat kadastrale në GIS dhe në bazën e të dhënave të konsumatorëve. Gjatë tërë periudhës planifikuese 2018 pritet të identifikohen konsumues ilegal të cilët do të shtojnë faturimin e ujit, pra do të behet implementimi i strategjise së aprovuar në vitin 2017, ku ekipin teknik për hulumtimin e rrjedhjeve teknike (fizike) të ujit duke filluar nga zonat më problematike. Ky aktivitet do të përfshijë veprimet “që nuk kanë kosto” siç janë: (i) inspektimet e rregullta të rrjetit. Pas ndërmarrjes së këtyre aktiviteteve pritet që uji i pafaturuar të zvogëlohet në më pak se 60% deri në fund të vitit 2018.

3.5 Caktimi i Pilot Zones për Veprim të Përbashket

Do të shikohet mundësia e caktimit të zona e cila në veti përmban ujëmatësin në zonë si dhe do të caktohet inkuasuesi, personi për gjetjen e humbjeve, personi për riparime dhe shkyçje për mos pages, ashtu që në këto zone do të caktohet një përgjegjës, ku pastoj do të monitorohet.

3.6 Grumbullimi i Ujërave të Zeza

Gjatë periudhës 2018-2020 planifikohet të investohet më tepër në mirëmbajtjen dhe riparime të rrjetit të kanalizimit me mjetet vetanake të Kompanisë, gjegjësisht rreth €50.000 për vit. Poashtu planifikohet pastrimi i rregullt, gradual, i rrjetit dhe pusëve të kanalizimit gjë që do të rezultojë në zvogëlimin e numrit të bllokimeve në kanalizim. Nga ekipi i GIS-it do të bëhet regjistrimi i numrit të pusëve të kanalizimit, pra në koordinata dhe në thellësi, ky aktivitet është edhe kërkesë e Bankës Gjermane KfW. Nga donacioni i KfW dhe Seco, do të bëhet inkuizimi i tubacionit ekzistues, ku do të kemi një gjendje reale në tubacione, pra bllokimet dhe gjendja e gypave. Gjatë vitit 2018 planifikohet të bëhet pranimi i kanalizimit në Junik dhe Decan.

3.7 Trajtimi i Ujërave të Zeza

Edhe gjatë tri viteve të ardhshme Kompania do të jetë e angazhuar sëbashku me donator, me implementimin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Zeza (ITUZ), sipas programit të Kompanisë Implementuese, ku marrëveshja me donator dhe Ministrinë & Komunitet është bërë më Tetor të vitit 2016. Ku sipas planifikimeve konsulencia e përzgjedhur do të nisë me punë gjatë vitit 2018.

4. Plani i Shërbimit Komercial

Shërbimi komercial do të vazhdojë me përmirësimin e aktiviteteve tjera bazë si: (i) leximi i konsumit të ujit të shfrytëzuar (leximi i ujëmatësve si dhe saktësia e leximit); (ii) përdatësimi i bazës së të dhënave; (iii) shtypja dhe shpërndarja e faturave; (iv) arkëtimi i borxhit të tanishëm dhe të vjetër; (v) relacionet me konsumatorë, (vi) komunikimi me konsumatorë.

Aktivitet më konkretë të cilat do të ndërmerren gjatë periudhës planifikuese për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit komercial janë:

4.1 Përdatësimi i bazës së të dhënave

Do të planifikohet që në mënyrë të rregullt të bëhet mbledhja e të dhënave në terren lidhur me konsumatorët e regjistruar me qëllim të përdatësimit të të dhënave për konsumatorët ekzistues. Kompania planifikon të ndërmerret aksionin

e nënshkrimit të kontratave me konsumatorët ekzistues dhe ata të rinj sipas kartes se konsumatorëvetë aprovuar nga vetë ARRU. Poashtu do të ndërmerren masat e verifikimit të të gjithë konsumatorëve pasiv dhe të aktivizimit të atyre që janë konsumues të ujit.

Gjatë vitit 2018 do të vazhdohet me aktivitetin tashmë të filluar të identifikimit të lidhjeve ilegale. Këtij aktiviteti do të i paraprin një fushatë intensive propagantistike përmes mediave për thirrjen për legalizim të konsumuesve që shfrytëzojnë ujin pa autorizim nga Kompania, kjo pastaj do të përcillet me organizimin e ekipës teknike dhe shërbimit me konsumatorë për gjetjen dhe regjistrimin e konsumuesve ilegal. Gjatë fushatës do t'iu bëhet me dije konsumuesve ilegal për përballjen me sanksione ligjore në rast të mos paraqitjes në baza vullnetare. Ndërsa konsumuesit e identifikuar tashmë do të regjistrohen në bazën e të dhënave të Kompanisë.

4.2 Instalimi i ujëmatësve

Gjatë periudhës së ardhshme tre-vjeçare Kompania planifikon të instalojë ujëmatës te modelit me te ri, ku behet ndalja dhe leximi nga distanca, instalimi do te behet tek konsumatorët te cilet nuk kane ujematëse, tek konsumatorët qe kane ujematësa te cilet nuk punojne, ne projektet e reja te përfunduara varesisht nga numri i lidhjeve, qe ne kete rast ka me qene Lugu i Baranit, me fshatrat: Zllapek, Llozhan, Grabovc, Doberdol, Turjak, Rashiq, Kotradiq, Vranoc, Baran, Zallapek, Kosuriq, Kamenica, Llugagji, Buqan, Gllogjan dhe Nepolesi dhe sipas kerkesave nga projektet e reja. Projektet e financuara nga Zvicëranet dhe Qeveria, per Pejë, Istog, Deçan dhe Klinë.

Kompania poashtu do të përkujdeset që të gjithë ujëmatësit e rinj të instaluar të jenë komform standardeve të përcaktuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/Agjensioni i Metrologjisë.

4.3 Saktësia e leximit të ujëmatësve

Pasi që gjatë vitit 2017 janë vërejtur parregullsi në leximin e ujëmatësve, gjatë periudhës planifikuese 2018 Kompania do të fokusohet në ngritjen e saktësisë së leximit të ujëmatësve duke riorganizuar lexuesit e ujëmatësve dhe ekipet e kontrollit. Poashtu do të obligohen lexuesit e ujëmatësve që të bëjnë leximet çdo dy muaj, në pajtim me procedurat e brendshme të Kompanisë. Ekipet e kontrollit në gjashtë muajt e parë të vitit 2018 do të aktivizohen gjatë gjithë kohës ndërsa në muajt dhe vitet në vijim do të angazhohen vetëm kohë pas kohe për të kontrolluar saktësinë e leximit të ujëmatësve. Në rastet e gjetjes së parregullsive, kompania do të ndërmerret masat ndëshkuese ndaj lexuesve të papërgjegjshëm.

Gjatë vitit 2018 do të rishikohet edhe programi pilot i ndarjes së aktivitetit të leximit dhe shpërndarjes së faturave nga aktiviteti i arkëtimit derë-më-derë, e cila besohet se do të sjell rezultate më të mira në lexim më të saktë. Nga ky sektor te te angazhohet personi i cili do te beje analizat e leximeve si dhe do te mbikeqyre leximet.

4.4 Faturimi

Faturimi do të vazhdojë të kryhet sipas procedurave të brendshme të Kompanisë duke u bazuar në lexim (aty ku ujëmatësit janë të instaluar dhe funksional), në vlerësim (aty ku ujëmatësit janë përkohësisht jashtë funksionit dhe kur nuk ka fare ujëmatës).

Në përgjithësi pritet të rritet vlera e faturimit krahasuar me periudhën paraprake. Arsyet për këtë janë rritja e numrit të konsumatorëve, leximi më i saktë i ujëmatësve, instalimi i ujëmatësve të rinj, aktivizimi i konsumatorëve pasiv (por që aktivisht kanë konsumuar ujin e ujësjellësit) dhe legalizimi i kyçjeve ilegale sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Faturat do të vazhdojnë të shtypen në baza mujore. Planifikohet që formati i faturës të rishikohet për të shtuar edhe disa informacione shtesë, të cilat kërkohen nga Rregulla e ARRU por edhe nga metodat e reja të arkëtimit (të paraqitura më poshtë). Mirëpo kjo do të ndodh pasi të jetë instaluar sistemi i ri i informatave menaxhuese.

Shpërndarja e faturave do të vazhdojë të bëhet në baza mujore nga punëtorët e Kompanisë.

4.5 Arkëtimi-Inkasimi

Për periudhën 2018 Kompania së pari planifikon të ngritë faturimin e ujit e pastaj edhe eficiencën e arkëtimit (vlerat në terma absolute janë të siguruara në formatin e Indikatoreve).

Me qëllim të ngritjes së arkëtimit do të ndërmerren veprimet E SHKYQJEVE si në vijim:

- Ndërmarrja e një fushate intensive të vetëdijësimit për qytetarët, që do të realizohet përmes TV dhe radiove lokale si dhe webfaqes së kompanisë.
- Identifikimi i konsumatorëve me shuma të larta të borxheve dhe realizimi i një takimi me secilin konsumatorë veçmas, ku qendrimet tona do të prezentohen tek konsumatorët dhe do të nënshkruhen kontratat për riprogramimin e borxhit sipas nevojës.
- Zgjidhja e rasteve sociale në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, konkretisht kërkesa drejtuar Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale për kompensimin e një shume të caktuar të faturimit për rastet sociale të identifikuar, ky proces është në vazhdim, ku vendimi do të jetë për të gjitha kompanit e Ujit në Kosovë.
- Do të bëhet përpjekje e vazhdueshme që të nisë arkëtimi për minoritetet, pra do të zhvillojme takime ashtu që të përfshihen të gjithë.
- Marrja e masave të çkyçjes individuale dhe kolektive për konsumatorët e pa ndërgjegjshëm, në bazë të rregullores përkatëse të ARRU dhe procedurave të brendshme të Kompanisë.

- Përmirësimi i shërbimeve ndaj konsumatorëve si dhe trajnimi i stafit me qëllim të përmirësimit të sjelljeve të tyre ndaj konsumatorëve.

4.6 Reziqet

Edhe në vitet në vijim Kompania mund të përballet me rreziqe të ndryshme të cilat do të mund të ndikojnë direkt ose indirekt në përmbushjen e normës së arkëtimit. Faktorët kryesor që vlerësohet se do të shkaktojnë mos realizimin e arkëtimit në nivelin e kënaqshëm, të identifikuar nga Kompania janë:

Direkt:

Mos-aftësia financiare për pagesë (rastet sociale)

Shkalla e ulët e punësimit të popullatës dhe fuqia e ulët ekonomike e tyre

Prolongimi i padive në gjykatat përkatëse ndaj konsumatorëve të pa përgjegjshëm.

Indirekt:

Faturimi në bazë paushalli.

4.7 Relacionet me konsumatorë

Zyra ekzistuese për relacionin me konsumatorë do të kompletohet edhe më tutje për të përfshirë paisjet si: kompjuter, printer, telefon fiks & fax, dhe gjërat tjera si: postera në lidhje me ujin dhe relacionin me konsumatorë, dhe shenjat postuese.

Kompania do të angazhohet në vazhdimësi të përmirësojë dhe shpejtojë procesin e shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve, përmes trajnimit të stafit që janë të angazhuar direkt në këtë proces si dhe instalimit të Modulit të relacionit me konsumatorë.

4.8 Komunikimi me publikun

Kompania planifikon të përmirësojë komunikimin me konsumatorë dhe publikun e gjërë përmes pjesëmarrjes së stafit relevant të Kompanisë në emisionet e TV dhe Radiove lokale në zonën e shërbimit. Për më tepër do të përdatësohet webfaqja e Kompanisë për të përfshirë të rejtat ditore/javore si dhe do të fillojmë me komunikimin e drejtëpërdrejtë me konsumatorët përmes postës elektronike (e-mail), SmS dhe rrjeteve sociale.

5 Plani Financiar

Ne planin Financiar gjate vitit 2018-2020, K.R.U "Hidrodrini" Sh. A do te bazohet nga analiza financiare e bere nga menaxhmenti dhe kryesisht fushveprimi i punes tone do te mbështëtet ne prezentimet me poshtë:

Kompania, si ofruese e shërbimeve publike që është, me tarifa te rregulluara nga ARRU për vitet 2018-2020, të gjitha përftimet financiare do të i'a kthen

konsumatorëve të vetë përmes ofrimit të shërbimeve. Me fjalë të tjera të gjitha të ardhurat e grumbulluara nga konsumatorët do të shpenzohen për operativë dhe investime.

5.1 Pagesa e shpenzimeve

Kompania planifikon që ti kryej të gjitha pagesat e shpenzimeve të domosdoshme që paraqiten me rastin e funksionimit normal të veprimtarisë, pra do të shpejtohet pagesat ndaj furnitoreve, ashtu që të gjitha obligimet të kryhen me kohë.

Transaksionet e përgjithshme të Kompanisë do të mbahen dhe regjistrohen duke respektuar Standardet e Kontabilitetit Kosovar dhe Kompania do të vazhdojë të raportojë në Administratën Tatimore të Kosovës.

5.2 Siguria financiare

Kompania do të krijoj procedurë për njohjen dhe matjen e provizionit për stoqet që levizin ngadal dhe të vjetëruara, do të bëjë regjistrin e provizionit në lidhje me stoqet që levizin ngadal dhe të vjetëruara. dhe do të trajtoj me efikasitet të besueshëm vlersimin e provizionit për stoqet e vjetëruara.

5.3 Grandet

Kompania do të përshpejtoj mbajtjen e deshmive të granteve nga donatorët, ashtu që me kohë sa ma të shkurter dhe në mënyrë të besueshme të bëjë evidentimin e tyre. Pas fillimit të Implementimit të ITUZ, Hidrodrini është i obliguar të bëjë pagesën e Tvsh, për mjetet e lehuara nga Qeveria dhe KK – Pejë, pra sipas ligjeve në fuqi.

5.4 Kontingjentet dhe detyrimet

Statusti i Pronesise:

Statuti i pronesise mbi shumicën e pronës, objekteve dhe pajisjeve të Kompanisë është ende i pazgjedhur dhe paqartësia materiale ekziston. Kompania do të përpiqet që me të gjitha kompetencat të faktoret relevant të zgjedh këto çështje komplekse.

Tatimi:

Regjistrimet si dhe librat e tatimeve do të mbahen me një përkushtim me të madh ashtu që Kompania do të koordinojë punët me autoritetet tatimore për një azhuret me të madh dhe për çdo paqartësi të mëtejshme masa efektive për eliminimin e tatimeve shtese apo gjobave nëse ekzistojnë.

5.5 Teknologjia informative

Kompania gjatë vitit 2018-2020 do të instalojë sistemin e centralizuar të TI-ve, duke përfshirë të gjitha hapsirat punuese, kjo nënkupton lidhjen e sigurt të të

gjitha godinave dhe zotimi i nje baze te te dhenave te vetme, si dhe do te kompjuterizohet edhe hyrjet dhe daljet nga puna me kartela elektronike për hyrje dhe dalje, si dhe ndrimi i kompjuterve ne sektoret kyç me komjuter të ri.

5.6 Planifikimi i Prokurimit Plerimnar

Plani i Prokurimit duhet të mbahet **konfidencial**
Kontratat për Furnizim:

Klasifikimi	Nr.	Përshkrimi i Kontratës	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përfaqëzuar Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	
Derivatet										
23	1	Furnizim me vajra sintetike	1.1	Vaj sintetik 5 /40	liter	200	4.5	900		
					Vaj sintetik 10/40	liter	250	4	1,000	
			1.2		Vaj sintetik 15/40	liter	400	3	1200	
			1.3		Vaj sintetik 20/50	liter	200	3	600	
			1.4		Vaj sintetik 90	liter	200	5.5	1100	
			1.5		Vaj hidroll 68	liter	700	3	2,100	
			1.6		Vaj ATF	liter	200	4	800	
			1.7		Vaj Glicerin	liter	50	4	200	
			1.8		Yndir EP2	Kg	100	4	400	
			1.9		Ujë për xhama 1/1	liter	500	0.9	450	
			1.1	Antifriz 100%	liter	600	2	1200	Tetor	
Totali i Vlerës								9,950		
Tjera										
10	2	Furnizim me lend djegëse	2.1	Pelet për nxemje	tone	15	250	3750	Tetor	

			2.2	Dru për ngrahje	m	35	45	1575	
Totali i Vlerës								5,325	
34	3		3.1	Pjes te ndryshme për mirembajtjen e motorit	Copë	Kontingjent	0	8,500	
	4	Pjese për mirembajtje të automjeteve	4.1	Pjes për mirembajtjen e elektrikes	Copë	Kontingjent	0	3,500	Gjate Vitit, mirembajtje
Totali i Vlerës								12,000	
34	6	Furnizim me Akumullatora	6.1	Akumlator Industrial për Inventor	Copë	5	400	2000	
	7		7.1	Akumulator për kamiona	Copë	11	180	1,980	
			7.2	Akumulator për Automj	Copë	10	70	700	Gjate Vitit, mirembajtje
Totali i Vlerës								4,680	
34	8	Furnizim me Goma	8.1	Goma për automjete	Copë	Kontingjent		5,000	
		Goma	8.2	Goma për Kamiona	Copë	Kontingjent		6,000	
	9		9.1	Goma për Bagera	Copë	Kontingjent		6,000	Gjate Vitit, mirembajtje
Totali i Vlerës								14,500	
34	10	Furnizim me Automjete	10.1	Automjete	Copë	8	5000	40,000	Gjate Vitit, mirembajtje
Totali i Vlerës								40,000	
24	11	Furnizim me kemikate për përpunim e ujit	11.1	Furnizim me Alumin Sulfat	Kg	7500	0.6	4,500	
	11		11.2	Furnizim me Polielektrolit	kg	1000	6	6,000	Gjate Vitit, mirembajtje


			11.3	Furnizim me reagensa, pjes për laborator	kontingjen	1	10000	10000	
	13		13.1	Furnizim me bambola për klor	copë	15	500	7500	
Totali i Vlerës								28,000	
Materiali për Mirembajtje									
29	14	Furnizim me gypa PE 40 deri Dn-600	14.1	Fazoneri dhe gypa	Copë	Kontingjent		80,000	
29	15	Furnizim me Fazoneri -	15.1		Copë	Kontingjent		30000	
29	16	Furnizim me ujematesa shtepiak	16.1	Furnizim me Ujematesa shtepiak	Copë	Kontingjent		150000	
